



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

29/01/2025

Prishtinë

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTEVE

Bazuar në nenin 53 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Administrimin e Dokumenteve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nxjerrë:

V E N D I M

Për anulimin e procedurës rekrutuese për pozitën “Zyrtar për Koordinim në Teren” me nr. reference RAN00015553.

- I. **ANULOHET** procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Koordinim në Teren”, me numër reference RN00015553, i publikuar me datën 21.10.2024 .

A R S Y E T I M

Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ka publikuar konkursin për pozitën “Zyrtar për Koordinim në Teren”, me numër reference RN00015553.

Me rastin e publikimit të konkursit, emri i grupit për pozitën është vendosur gabimisht “Administrim i Përgjithshëm”, sipas të cilit kërkohet arsimim i paspecifikuar, ndërsa, grupi që do duhej të specifikohet “Specialist Zgjedhor”, pasi që kërkohen drejtimet specifike si “Administratë Publike, Ekonomik, Juridik, Sociologji, Statistikë, Matematikë”. Ndërsa, grupi “Specialist i administrimit të përgjithshëm” kërkon “Arsim i paspecifikuar”. Pra, grupi i profesional i përzgjedhur në konkursin e publikuar nuk përkon me kriteret e grupit që do duhej të specifikoheshin konform Rregullores Nr.08/2024, për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, SHTOJCA NR. 1: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për secilën klasë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) si dhe asaj që është kërkuar.



Gjithashtu, njësia përgjegjëse e institucionit konstaton se, kandidati me numër të aplikacionit RAN0072904 dhe kandidati me numër të aplikacionit RAN0070749, nuk janë përfshirë në listën e ngushtë të kandidatëve e të cilët i kanë plotësuar kriteret për të kaluar fazën e verifikimit paraprak, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

